



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 553/3 prot.

Tiranë, më 17. 06. 2021

V E N D I M

Nr. 110, datë 17. 06. 2021

Mbështetur në nenin 32, pika 1, gërma a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën me Nr. 47, datë 29.03.2021, të E. L. kundër Bashkisë Gjirokastrë dhe Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore¹ (ASHBVM), në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “*bindjes politike*”².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi³,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna, subjekti ankues në mes të tjerash informon se nga data 06.02.2019 është emëruar në pozicionin e Inspektorit të Terrenit në Sektorin e Pyjeve dhe Kullotave, Agjencia e Bujqësisë Veterinarisë dhe Mjedisit, pranë Bashkisë Gjirokastrë. Pas zgjedhjeve vendore të vitit 2019, në pozicionin e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë u emërua F. G., ardhur nga radhët e subjektit politik, Partia Socialiste e Shqipërisë. Me ndryshimin e kryetarit të bashkisë, ankuesi pretendon se u ndryshua drejtori dhe përgjegjësi i sektorit të Pyjeve dhe Kullotave i Agjencisë së Bujqësisë Veterinarisë dhe Mjedisit, duke u zëvendësuar me anëtarë të Partisë Socialiste. Në këtë moment ankuesi pretendon se ndaj tij ka nisur situata diskriminuese për të dhe kolegët e tij të cilët ishin emëruar nga ish kryetarja e mëparshme e Bashkisë Gjirokastrë.

¹ Institucion në varësi të Bashkisë Gjirokastrë.

² Referuar kartës së anëtarësisë nr. 17228, datë 31.08.2016, E. L. është anëtar i subjektit politik: Lëvizja Socialiste për Integrim.

³Në vijim do t'i referohemi me akronimin KMD.

Nga momenti i emërimit të drejtuesve të Agjencisë së Bujqësisë Veterinarisë dhe Mjedisit, ai dhe kolegët e tij janë ngarkuar me detyra, duke kryer inspektime në largësi 10 deri 20 kilometra nga vendi i punës. Gjithashtu, janë detyruar të zhvillojnë inspektime pa mjete transporti, në orare 17:00 deri në 23:00, si dhe të paguajnë biletat e udhëtimit apo mjetet e transportit për të zhvilluar detyrën e caktuar nga eprorët.

Ndërkaq, ankuesi thekson faktin se në momentin që inspektorët kanë konstatuar dru të prera në pyll, janë detyruar t'i ngarkojnë në krah deri në vende ku mund të kishin akses mjetet e transportit të Ndërmarrjes Komonale të Bashkisë Gjirokastrë. Ndërkohë që kjo detyrë nuk mund të ushtrohet nga ana e tyre. Sipas ankuesit, ai dhe kolegët e tij kanë kërkuar t'i sigurohen mjete transporti për kryerjen e detyrave të ngarkuara, por nuk kanë marrë asnjë përgjigje, madje ndaj tyre është marrë masë disiplinore për moszbatimin e urdhrave të dhënë nga eprorët.

Ankuesi pretendon se është përballur me një situatë të pabarabartë dhe diskriminuese që me emërimin e eprorëve të tij, pasi inspektorët e emëruar prej tyre dhe me bindje politike të njëjta me ta, qëndronin në zyrë dhe nuk dërgoheshin në inspektime si ai.

Në vijim, ankuesi sqaron se është njoftuar më datë 22.01.2020, me shkresën nr. 531 prot., për ndërprerjen e marrëdhënieve financiare për shkak të ristrukturimit të Bashkisë Gjirokastrë. Sipas tij, ndërprerja e marrëdhënieve të punës nga ana e punëdhënësit, ka ardhur për shkak të bindjeve të kundërta politike me të dhe jo për shkak të ristrukturimit të Bashkisë Gjirokastrë, pasi menjëherë pas largimit të tij nga puna, është zëvendësuar me punonjës, anëtarë të Partisë Socialiste të Shqipërisë.

Në përfundim subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe kthimin në vendin e punës.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar⁴, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Neni 7 i LMD-së⁵, në pikën 1 të tij, parashikon se: “Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë,

⁴ Në vijim do t'i referohemi me akronimin LMD.

⁵ Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi ose grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe personash, përbën diskriminim”.

Bazuar në nenin 32/1/a të LMD-së, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Përsa më lart, referuar nenit 33, të këtij Ligji, ankesa përmban elementët e kërkuar nga ky ligj.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, si dhe ato çështje që janë brenda afatit kohor për shqyrtim sipas parashikimeve të LMD-së.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Nëpërmjet shkresës nr. 553/1 prot., datë 06.04.2021 nga ana e KMD i është kërkuar informacion dhe dokumentacion provues⁶ Bashkisë Gjirokastrë, lidhur me pretendimin e ankuesit.

Nëpërmjet shkresës⁷ me nr. 3574/1 prot, datë 19.04.2021, Bashkia Gjirokastrë ka dërguar parashtrimet e veta dhe kopje të dokumentacionit të kërkuar, duke sqaruar ndër të tjera se: “...E. L. emëruar në pozicion pune Inspektor terreni në Sektorin e Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave në ish-ASHBVM, pranë Bashkisë Gjirokastrë, i janë ndërprerë marrëdhëniet financiare për shkak të ristrukturimit dhe përfundimit të afatit të njoftimit prej 2 (dy) muaj më 30.03.2020 në mbështetje të ligjit Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” Nenet 9, Pika 1.1 shkronja “b” dhe 64, nenin 143, 144, 145 të ligjit nr. 7961/1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Bashkisë Nr. 154, datë 26.12.2019 “Mbi miratimin e numrit

-
- ⁶ - Argumentimin, lidhur me pretendimet e subjektit ankues për diskriminim për shkak të bindjes politike.
- Kopje të dosjes personale të E. L. (Emërimet, kontrata pune, vlerësime performance, masa disiplinore, nëse ka, Librezë Pune, etj.
 - Kopje të procedurës së ndjekur lidhur me dhënien e masave disiplinore dhe për largim nga puna ndaj ankuesit.
 - Kopje të Rregullores së Brendshme të Agjencisë dhe kopje të përshkrimit të punës për pozicionin “Inspektor”, të miratuar me Urdhrin nr. 12, datë 05.04.2017 “Për përshkrimin e hollësishëm të detyrave për pozicionin “Inspektor terreni” në sektorin e administrimit të pyjeve dhe kullotave”.
 - Informacion lidhur me emërimet e punonjësve në Agjencinë e Bujqësisë Veterinarisë dhe Mjedisit, pas emërimit të S. R.
 - Një kopje e dosjes personale si dhe kopje të procedurës së ndjekur për emërimin e tyre.
 - Informacion nëse për të njëjtat shkelje janë larguar dhe punonjës të tjerë nga detyra. Nëse po, një kopje të procedurës së ndjekur për secilin rast.
 - Informacion nëse kjo çështje po ndiqet gjyqësisht. Nëse po, një kopje të akteve.

⁷ Protokolluar pranë KMD-së me Nr. 553/2 prot., datë 21.04.2021

maksimal të punonjësve dhe nivelit të pagave në Bashkinë Gjirokastrë”; Urdhërit Nr 35, datë 21.1.2020 të Kryetarit të Bashkisë “Për miratimin e organigramës së administratës së Bashkisë Gjirokastrë”, i ndryshuar; si dhe të njoftimit Nr. 531 prot, datë 22.01.2020 “Mbi shkëputjen e marrëdhënieve të punës”.

Kontrata e ankuesit ishte me kohëzgjatje të pacaktuar dhe përfundon kur zgjidhet nga njëra palë në përfundim të procedurës dhe në përfundim të afatit të njoftimit. Ndodhur në kushtet e nenit 141, 143, 144 të Kodit të Punës së Republikës së Shqipërisë dhe duke qenë se ankuesi kishte një kohëzgjatje prej 1 viti, për të zgjidhur kontratën me afat të pacaktuar, palët respektuan një afat njoftim prej më shumë se 1 muaj pasi kohëzgjatja ishte deri në një vit.

Bashkia Gjirokastrë bazuar në dispozitat ligjore të lartpërmendura si dhe në Kontratën e Punës Individuale të punonjësit, ka zbatuar me përpikmëri dhe përgjegjshmëri procedurën e ndërprerjes së marrëdhënieve të punës. Ndodhur në këto kushte, zgjidhja e kontratës së punës ka ardhur si rezultat i zgjidhjes me efekt jo të menjëhershëm dhe jo të njëanshëm. Pretendimi i subjektit ankues për diskriminim për shkak të bindjes politike mbetet i paprovuar. Zgjidhja e kontratës së punës është bërë për shkaqe të justifikuara dhe të ligjshme.

Punëdhënësi pas kohës së marrjes në provë 3 (tre) muaj dhe pas përfundimit të afatit të njoftimit prej më shumë se 1 (një) muaj ka qenë në pritje të prapësimeve me shkrim të njoftimit të punëmarrësit por nga ana e tij nuk ka ardhur asnjë kundërshtim.

Punëdhënësi, për sa ka pretenduar ankuesi nuk i ka zgjidhur marrëdhëniet e punës për shkak të dhënies së masës disiplinore. Punëmarrësi në këtë rast e humb të drejtën e paraqitjes së ankesës në formë diskriminimi politik.”

2. Në përfundim, me anë të e-mailit datë 04.06.2021, ankuesi sqaroi ndër të tjera se: “Për sa i përket vërejtjes së parë jam vënë në djeni pasi ka qënë Përgjëgjës Agjencie A. M. kundërshtar politik me Kryetarin e Bashkisë që u mandatua me ato pseudo zgjedhje lokale për Kryetar Bashkie të vitit 2019. Ndërsa për vërejtjen e dytë nuk jam vënë në dijeni fare dhe për kandidimin për statusin e nëpunësit civil nuk jemi njoftuar. Kolegë të mijë që ishim në të njëjtën kohë, ishin pa status dhe vazhdojnë në ato pozicione por nuk jam informuar nëse kanë konkuruar për status të nëpunësit civil. Por, mua më kanë larguar nga pozicioni i punës me preteksin e shkrirjes së vendit të punës...”

III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes.

A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm

Ligji “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 1 sipërcituar dhe nenin 3/1, parashikojnë se: “Diskriminim” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Subjekti ankues ka lidhur marrëdhëniet e punës me Bashkinë Gjirokastrë, me datë 06.02.2019, në pozicionin e Inspektor Terreni, pranë Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore (ASHBVM), Agjenci në varësi të Bashkisë Gjirokastrë, nëpërmjet Urdhërit nr. 67, datë 06.02.2019 të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë. E. L. ka qenë në marrëdhënie pune deri me datë 23.03.2020, datë në të cilën është bërë dhe lirimi i tij nga detyra, nëpërmjet Urdhërit nr. 213, datë 30.03.2020 të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë.

Në zgjedhjet vendore të datës 30.06.2019, Kryetar i Bashkisë Gjirokastrë u zgjodh F. G., mbështetur nga subjekti politik, Partia Socialiste e Shqipërisë.

Ndërkaq, nga informacioni i dhënë nga ana e ankuesit ai pretendon se me emërimin e F. G. në pozicionin e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë, ndaj tij dhe kolegëve ka nisur situata diskriminuese për shkak se ishin emëruar nga ish kryetarja e mëparshme kësaj bashkie. Lidhur me këtë, ankuesi është shprehur për veprime diskriminuese, por pa specifikuar raste konkrete, që kanë ardhur duke u përshkallëzuar deri në ndërprerjen e marrëdhënieve të punës. Pra, ankuesi nuk ka vënë në dispozicion të Komisionerit informacion apo argumenta, me anë të të cilave të provohet fakti që Bashkia Gjirokastrë apo Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore, si subjekte ndaj të cilëve është paraqitur ankesa, nëpërmjet veprimeve apo mosveprimeve të tyre, të kenë vënë në pozita të padrejta, të pabarabarta apo të pafavorshme ankuesin, në momentin e ndryshimit të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastrë.

Në këtë kuadër, Komisioneri referuar provave dhe informacionit të vënë në dispozicion nga palët, do të shprehet lidhur me pretendimin për diskriminim, sa i përket procedurës së ndjekur nga ana e Bashkisë Gjirokastrë për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës me ankuesin, si dhe nëse procedura e ndjekur ka vënë atë në pozita të padrejta, të pabarabarta e të pafavorshme në raport me punonjës të tjerë.

Ankuesi është drejtuar pranë Komisionerit, me ankesë për diskriminim kundër subjekteve Bashkia Gjirokastrë dhe Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore (ASHBVM). Nga provat e administruara, ASHBVM është Agjenci në varësi të Bashkisë Gjirokastrë, si e tillë ajo nuk ka kompetencë për lidhjen apo ndërprerjen e kontratës së punës me subjektin ankues. Në këto kushte, Komisioneri do të vijojë shqyrtimin e çështjes, vetëm ndaj Bashkisë Gjirokastrë, si subjekt që pretendohet të ketë kryer diskriminimin.

Pak kohë pas emërimit të F. G. në krye të Bashkisë Gjirokastrë, mbështetur në nenit 64/j të Ligjit nr. 139/2015 *“Për Vetëqeverisjen Vendore”* i ndryshuar, ku parashikohet se një ndër kompetencat e kryetarit të bashkisë është *miratimi i strukturës, organikës e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njëjsteve e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi*, me Urdhërin nr. 35, datë 21.01.2020, u miratua Struktura dhe Organika e re e Bashkisë Gjirokastrë. Me miratimin e saj, disa nga pozicionet e punës u shkurtuan dhe nga 632 numri i punonjësve u reduktua në 590. Ndryshimet e pësuara në strukturë prekën edhe pozicionet e punës së Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore, ku pjesë e së cilës ishte dhe E. L. Me

strukturën e re, Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore, nga njësi nën varësi të Bashkisë Gjirokastër, u ndryshua në Drejtoria e Zhvillimit, të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit, brenda organikës së Bashkisë Gjirokastër. Numri i punonjësve të Njësisë nga 25 u reduktua në 19, dhe 1 pozicion *Inspektor Terreni* ishte reduktuar me strukturën e re nuk ekzistonte më. Gjithashtu, Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, u bë Sektori i Këshillimit, Shërbimeve Bujqësore dhe Administrimit, Monitorimit dhe Mbrojtjes së Tokës, duke reduktuar edhe numrin e punonjësve nga 11, në 8 punonjës.

Më poshtë pasqyrohet si ka ndryshuar Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, në atë të Sektorit të Këshillimit, Shërbimeve Bujqësore dhe Administrimit, Monitorimit dhe Mbrojtjes së Tokës:

Sektori i Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave (11 pozicione pune)	Sektori i Këshillimit, Shërbimeve Bujqësore dhe Administrimit, Monitorimit dhe Mbrojtjes së Tokës (8 pozicione pune)
Përgjegjës Sektori – 1 pozicion	Përgjegjës Sektori – 1 pozicion
Inspektor Terreni – 6 pozicione	Inspektor Terreni, Pyje, Kullota - 5 pozicion
Specialist Pyjesh-Magazinier – 1 pozicion	
Specialist Pyjesh – 3 pozicione	Sektori Pyjesh, Kullota, Mjedisi - 2 pozicione

Përpara ndryshimeve të pësuara, pozicionet e punës së Agjencisë së Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore, rregulloheshin me Ligjin Nr. 7961, datë 12.07. 1995 “*Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë*” i ndryshuar. Me ndryshimin e Strukturës, Agjencia e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore, u shkri dhe u formua Drejtoria e Zhvillimit, të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit. Në drejtorinë e sapoformuar evidentohet se rregullimi i marrëdhënieve të punës tashmë do të bëhej mbështetur në Ligjin nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

Përsa më sipër, nga ana e Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër, u nis procedura për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës për të gjithë punonjësit që prekeshin nga ndryshimi i Strukturës. Në këtë kuptim, gjatë muajit Janar 2020, u njoftuan edhe të gjithë Inspektorët e Terrenit që bënin pjesë në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore, si më poshtë vijon:

- Me shkresën nr. 531 prot., datë 22.01.2020, u njoftua E. L., i cili mbante pozicionin *Inspektor Terreni*, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit.
- Me shkresën nr. 530 prot., datë 22.01.2020, u njoftua N. L., i cili mbante pozicionin *Inspektor Terreni*, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit.
- Me shkresën nr. 858 prot., datë 30.01.2020, u njoftua V. B., i cili mbante pozicionin *Inspektor Terreni*, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit.
- Me shkresën nr. 856 prot., datë 30.01.2020, u njoftua N. SH., i cili mbante pozicionin *Inspektor Terreni*, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit.

- Me shkresën nr. 586 prot., datë 23.01.2020, u njoftua M. R., i cili mbante pozicionin *Inspektor Terreni*, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për shkak të ristrukturimit.

Referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion, nga Bashkia Gjirokastrë me shkresën Nr. 385/1 prot., datë 03.02.2020, në kuadër të shqyrtimit të ankesës Nr. 141, datë 06.11.2019, të paraqitur nga shtetasi G. K., Komisioneri është vënë në dijeni se një pozicion pune Inspektor Terreni ishte i paplotësuar. Pra, nga dokumentacioni i administruar rezultoi se ishin 5 punonjës të emëruar në pozicionin Inspektor Terreni dhe 1 (një) pozicion ishte i lirë.

Gjithashtu, me ndryshimet e pësuara në Strukturë, janë përcaktuar përshkrimet e pozicioneve të punës dhe kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë Inspektorët e Terrenit, Pyje, Kullota. Në rastin konkret, kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë, janë si më poshtë:

- **Inspektor Terreni, Pyje, Kullota:**

Arsimi: Niveli minimal i diplomës “Bachelor”

Përvoja: - Të kenë eksperiencë 2 vite në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura është kërkuar për 4 pozicione të shpallura vakante.

- Të ketë eksperiencë 4 vite në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura është kërkuar për 1 pozicion të shpallur vakant.

Përsa më sipër dhe mbështetur në informacionin e administruar, rezulton se janë nënshtruar procedurave të konkurimit për pranimin në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicionet e punës Inspektor Terreni kandidatët përkatës. Pas, procedurave të konkurimit, janë emëruar sipas akteve të emërimit të nëpunësve civil në periudhë prove, 5 punonjës në pozicionet Inspektor Terreni, Pyje, Kullota. Nga informacioni i administruar, një ndër kandidatët e kualifikuar dhe emëruar, pas konkurimit për pozicionet vakante Inspektor Terreni, Pyje, Kullota, është shtetasi A. K., i cili ka mbajtur më parë pozicionin e Inspektorit të Terrenit në Agjencinë e Shërbimeve Bujqësore, Veterinare dhe Mjedisore.

Mbështetur në dokumentacionin e administruar, ankuesi gjatë viteve 1997-2001 ka përfunduar arsimin e lartë në Universitetin “Eqerem Çabej” të Gjirokastrës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në degën Kimi-Biologji. Referuar Librezës së Punës, ankuesi ka një eksepriencë prej më shume se 10 vite pune në administratën shtetërore.

Përsa më sipër, evidentohet se pavarësisht faktit që nga ana e Bashkisë Gjirokastrë janë ndjekur procedurat e shpalljes së vendeve vakante për pozicionet e punës Inspektor Terreni, Pyje, Kullota, ankuesi nuk rezulton të ketë paraqitur asnjë dokumentacion për të konkuruar për pozicionet e lira të punës. Nga informacioni i administruar, ankuesi i plotësonte të gjitha kriteret për pozicionet e shpallura vakante, por nga ana e tij nuk rezulton të ketë shprehur dëshirën për të konkuruar.

Në analizë të veprimeve të sipërcituara dhe në zbatim të implementimit të Strukturës së re Organizative të Bashkisë Gjirokastrë, evidentohet se është ndjekur e njëjta procedurë për të gjithë punonjësit e Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave. Pra, në këtë rast konstatohet se ankuesi është vënë në të njëjtat kushte me punonjësit e tjerë të Sektorit të Administrimit të Pyjeve dhe Kullotave, para dhe pas ndryshimeve të strukturës organizative, të cilët janë nënshtruar procedurës së ristrukturimit të Bashkisë Gjirokastrë. Ndërsa, përsa i përket faktit që ankuesi nuk është rimarrë në një nga pozicionet e lira të punës, krahasuar me punonjësit e tjerë, u evidentua se pavarësisht faktit që ai i plotësonte kriteret e pozicioneve të lira të punës, të bëra publike nga Bashkia Gjirokastrë, nuk ka shprehur vullnetin e tij për të konkuruar.

Përsa më sipër, Komisioneri konstaton se ankuesi nuk është vendosur në kushte të pabarabarta apo trajtuar në mënyrë të pafavorshme, në raport me punonjësit e tjerë të Drejtorisë së Zhvillimit, të Bujqësisë, Pyjeve, Ujitjes dhe Kullimit apo Sektorit të Këshillimit, Shërbimeve Bujqësore dhe Administrimit, Monitorimit dhe Mbrojtjes së Tokës, sa i përket procedurave të zgjidhjes së marrëdhënieve të punës dhe emërimit pas ndryshimeve të Strukturës Organizative të Bashkisë Gjirokastrë.

Diskriminimi përkufizohet në nenin 3, pika 1 të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, si: *“Çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi.”*

Në nenin 12/1/c) të Ligjit nr. 10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Ndalohet diskriminimi i personit në lidhje me të drejtën e tij për punësim. Diskriminimi përfshin çdo dallim, kufizim ose përjashtim që bazohet në shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe që, ndër të tjera, ka lidhje me: trajtimin e punëmarrësve në vendin e punës, duke përfshirë trajtimin e tyre gjatë vendosjes ose ndryshimit të kushteve të punës, shpërblimit, përfitimet dhe mjedisin e punës, trajtimin lidhur me trajnimet profesionale ose gjatë procesit disiplinor apo lidhur me pushimin nga puna ose zgjidhjen e kontratës së punës”.*

Diskriminimi karakterizohet nga trajtimi i diferencuar, pra duhet të demonstrohet se viktimja e pretenduar është trajtuar në mënyrë më pak të favorshme për shkak të një karakteristike që përfshihet në “shkakun e mbrojtur”. Trajtimi më pak i favorshëm përcaktohet me anë të krahasimit ndërmjet viktimës së pretenduar dhe një personi tjetër në një situatë të ngjashme, i cili nuk posedon karakteristikën e mbrojtur.

Për sa më sipër, në referencë të nenit 7/1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri gjykon se Bashkia Gjirokastrë, nuk ka ndërmarrë veprime që e kanë ekspozuar subjektin ankues ndaj një trajtimi të pabarabartë apo disfavorizues.

Nga analiza e provave të vëna në dispozicion nga palët, Komisioneri vlerëson se nuk kemi një trajtim të pabarabartë apo të pafavorshëm të subjektit ankues.

Në mungesë të një trajtimi të pabarabartë, Komisioneri arrin në konkluzionin që nuk kemi të bëjmë me një sjellje diskriminuese nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, për shkakun e pretenduar nga ankuesi.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 1, nenin 3/1, neni 7, nenin 12/1/c, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pika 10, të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e mosdiskriminimit të subjektit ankues, E. L., në të drejtën për punësim, nga ana e Bashkisë Gjirokastrë, për shkakun e pretenduar prej tij.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankimim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA

(Shkaku: Bindjet politike)

(Fusha: Punësim)